

## 2

Bora fërgëllonte nga emocionet e fluturimit, një përjetim tjetër ngazëllues pos atij që kishte provuar në skaf. Ndihej humbëtare në atë pikë të hapësirës dhe përherë e pushtuar nga një ngjethmë. Gjithçka ishte e ëndërrt - qielli me re të pakta, malet që zbardhnin nga bora dhe akullnajat atje poshtë, luginat dhe fushat e blerta, lumejtë e ndritshëm, qytetet me bukuri vezullimtare, shtëpitë e veçuara, që dukeshin aq të vogla. Ja edhe deti me konturet e tij buzëqeshëse, me një grykë lumi në breg e me disa ishuj të vegjël.

Në altoparlant u dëgjua një zë femre që u thoshte pasagjerësve se po u afroreshin aeroportit *Heathrow* të Londrës dhe u lutej të lidhnin rripat e sigurimit...

Po binte mbrëmja dhe ai aeroport gjigant gjithë sy e lëmshe dritash shumëngjyrëshe dhe ato uturima avionësh që uleshin e ngriheshin dhe ato lëvizje, vrullima e rrapëllima të gjithandejshme e shushatën fare. Ajo mbante shtrënguar dorën e Arturit dhe vështronte rrotull e nemitur.

Ecnin përgjatë një rrugine llapëtitesë, gjithë lule, globe, tabela e reklama të ndriçuara dhe Bora vazhdonte të ishte mendjehumbur si Liza në Botën e Çudirave. Zemra i rrinte fort dhe nuk e shkëpuste dorën nga dora e Arturit.

- Sa bukur! - klithi. - Edhe pak frikë, ë?

Arturi i shtrëngoi dorën dhe e mbante vështrimin te supet e Serxhit që ecte përpara tyre. Në skaj të një parkingu të vizuar, pranë një veture të ndalur, Serxhi u ul për të lidhur këpucën dhe u zhduk. Me Borën për krahu, Arturi eci drejt veturës.

- Disa shokë më prematuan se do të dilnin të na prisnin dhe paskan dalë, - tha me ton të gëzuar.

Bora nuk foli. Dukej shumë e emocionuar për të thënë një fjalë dhe vetëm shikonte përqark si e magjepsur. Gjithë ajo larmi dritash,

gjallëri e lëvizje nuk kishte të krahasuar me ç'kishte parë në Milano.

Në timon ishte Korab Gjoleka, një tip çubardhë si negativ filmi, skilak, me fytyrën gjithë puçrra; pranë tij qe ulur Sefedin Dajlani, një bicërr burrë, shulak, me një jelek kaki e me një shami të kuqe me pulla të zeza në kokë, të cilin, kur e pa, Borës i erdhi për të qeshur, se i kujtoi xhuxhat në filmin *Borëbardha*, kurse në ndenjësën e pasme ishte Ardian Nikolla, një riosh imcak me syze miopi dhe me flokë të zinj të qethur ballaboks.

Arturi qëndroi një grimë pa folur dhe u gjallërua.

- Ata janë.

Sefa zbriti nga makina dhe eci drejt tyre krahehapur e fytyrëqeshur. Arturi uli kokën nga Bora dhe i pëshpëriti:

- Janë djem të mirë. Do të na ndihmojmë sa të rregullohem.

Me një pamje miqësore Sefa toki dorën me Borën e me Arturin.

- Mirë se erdhët në Londër!

Ai hapi derën e pasme. E nxitur nga vështrimi i Arturit, Bora hipi duke pritur që të hipte edhe ai, mirëpo hipi Sefa, që u ul pranë saj dhe mbyll derën. Arturi vrapoi për të hipur te vendi pranë shoferit, që ishte bosh, por Korabi e nisi makinën menjëherë. Bora u befasua aq shumë, sa për një çast mbeti pa frymë.

- Ndaloni! - thirri ajo duke parë përtej xhamit të pasmë e pushtuar nga tmerri. - Prisni të vijë dhe Arturi!

Dhe zgjaste kokën për të parë nga xhami i pasmë për Arturin, por makina qe bërë pjesë e lumnajës së makinave të tjera.

- Pse nuk pritët të hipte dhe ai? Ndaloni! Dua të zbres!

Askush nuk foli. Bora vazhdonte të bërtiste me sa kishte në kokë.

- Mos bërtit, - i tha Sefa me të butë. - Do të vijë. Ne jemi miqtë e tij.

Makina ndaloi nga trafiku dhe Bora zgjati dorën te doreza e derës në të djathtë për ta hapur, por Ardi, i ulur pranë saj, ia largoi me të butë. Ajo i hodhi një vështrim gjithë urrejtje dhe vazhdoi të përpëltej e të godiste me duar xhamin e pasmë.

- Ndaloni! Dua të zbres! Jeni në vete?! O ma!...

Arturi qëndroi gjatë i palëvizur, me vështrimin të mbërthyer përpara, edhe pse automobili kishte kohë që qe përpirë nga lumi i makinave. Fshiu një pikë lot dhe bëri disa hapa. Serxhi i shkoi pranë dhe i hodhi dorën në sup.

- Eja të marrësh honorarin.

I vuri dorën një taksie dhe hipën të dy.

Po afrohej mesnata. Detektivi Riçard Uilkins ishte duke ngarë *Fordin* e tij luksoz në *New Oxford Street*, të cilën e la dhe ktheu djathtas, në *Dean Street*. Sapo qe kthyer nga një shërbim pune dhe po shkonte në saunën *Black Rose* në Soho për t'u ngarritur një copë herë me Hana Uinterin, të dashurën e vet.

Ishte te të pesëdhjetat, thatim, symprehtë, shogaq, hundëshpatë, buzëhollë, i veshur me tuksedo, me këmishë e kravatë. Borsalinën e kishte lënë mbi kruskot. Sa herë që shkonte te Hana në *Frith Street* hidhte një sy rrotull për ndonjë bandë rrugaçësh, të droguarish a keqbërësish. Ishte qen i punës, thuajse nuk bënte dallim midis orëve të pushimit dhe orëve të shërbimit.

Edhe në atë orë të vonë Sohoja llamburiste nga dritat dhe ziente nga gjallëria. Njëpër qoshe pallatesh dhe bri semaforëve binin në sy prostitutat, që qëndronin në vend apo lëviznin ngadalë; nga baret e ndriçuara dëgjohej muzikë; tek-tuk shiheshin policë; njëpër klube hynin e dilnin çifte ose grupe të përziera meshkujsh e femrash.

Korab Gjoleka e ndaloi veturën përpara një pallati në anë të *Soho Square*, që ishte një lulishte me drurë të lartë. Pasi hodhi një vështrim përçark, zbriti. Zbritën edhe Sefa me Ardin, kurse Bora nuk lëvizi. Ajo shikonte rrotull me frikë dhe dridhej. Sefa futi kokën në makinë dhe i tha me të butë:

- Zbrit. Këtu është shtëpia e një shoqes sonë.

Ai zgjati dorën drejt saj, por Bora iu shmang me inat e neveri.

- Më çoni ku më morët! Se do të ulërij!

Sefa e mbërtheu me duart e tij si ganxha dhe e tërhoqi me aq forcë, sa ajo do të qe shkapetur në trotuar po të mos e kishte mbajtur ai.

- Ej! Je i çmendur?

Riçardi vazhdonte ta ngiste makinën anash *Soho Square* dhe në rrugën që kufizohej me të, nën ndriçimin e poçit të neontë, pa një veturë të ndalur. Njerëzit që zbritën prej saj, edhe pse si silueta, iu dukën të njohur, përveç një vajze fare të re, të cilën nuk ia kishin zënë sytë më parë dhe që për nga mënyra se si qëndronte duhej të ishte e sapoardhur. Riçardi e ndaloi makinën buzë trotuarit, zbriti, çuliti veshët, dhe duke u kujdesur të mos u binte në sy të personave që ishin me vajzën bëri sikur kërkonte diçka në makinë.

Bora rrinte e tromaksur, fytyrëmpirë, si një mëze trembalake, duke i parë vjedhtazi ata të panjohur që e kishin sjellë aty dhe që drita e kithtë e poçit i bënte edhe më të përçudnuar, llahtarisht gjakngrirës dhe, Oh, ç'ishte dhe një pyll i zi aty, në atë vend të huaj, ku ajo e gjente veten në mënyrën më të pabesueshme, a thua se gjithçka kishte ndodhur në ëndërr, jo në të vërtetë, dhe ç'punë kishin ata me të, përse e kishin marrë?

Sefa dhe Korabi e kapën nga krahët.

- Eja, zemër, - i tha Korabi. - Arturi do të vijë, mos ki merak. Ne jemi baza e tij këtu.

Bora i dha trupit vrullshëm për t'iu shkëputur kapësve dhe nuk bëri çap, e zhagmitur nga dyshimi se po e mashtronin. Korabi dhe Sefa shikonin rrotull gjithë frikë. Plot njerëz kalonin nëpër të dy trotualet, por duket nuk e kishin mendjen tek ata. Gjithsesi dikush mund t'i pikaste dhe Sefa e humbi durimin.

- Lëviz! - i tha Borës me ton të prerë.

- Kurrë! Pa ardhur Arturi, kurrë!

- Të thamë që do të vijë! Eja.

- Jo. Po më morët me zor, do të bërtas!

Sefa e zbuti tonin:

- Ti e dëgjove vetë kur ai tha se ne jemi miqtë e tij.

- Kur jeni miqtë e tij, pse nuk pritët të hipte edhe ai?

- Qëndroi për një punë dhe do të vijë.

- Për një punë! - Ajo u kërvesh me tallje. - Ai vrapoi të hipte, por ju e nisët makinën si të çmendur!

- Ndaç beso, ndaç mos beso, por ai qëndroi për një punë dhe është miku ynë.

- E merrni në telefon që të flas me të.

- Ai sa ka ardhur, nuk punon celulari i tij këtu. Ai do të na marrë vetë. Eja.

- Nuk punon celulari?! Po të ishte në Itali, nuk do ta merrnit dot? Zëre se është në Itali dhe njësoj flisni.

- Nuk është ashtu, po eja. Na vjen shumë keq që nuk na beson.

- Nuk ju besoj! Më lini, se do të gjej një polic. Le ta ftillojë policia këtë punë.

Sefa u murrëtye në fytyrë.

- Po ti që je shqiptare dhe ke ardhur në Angli me pasaportë italiane, do ta kesh të lehtë me policinë? Ç'pasaportë paraqite ti në aeroport?

Bora u shugat, madje trupin ia përshkuan mornica të ftohta. Ishte e vërtetë që kishte ardhur në mënyrë të parregullt, por duke qenë e shoqëruar nga Arturi, nuk e kishte vrarë mendjen fare për këtë. U ndje e çarmatosur dhe balli iu mbush me djersë të ftohta. Puna që bërë lëmsh dhe zhdukja e Arturit nga prania e saj i kishte hapur në shpirt një vrimë të zezë të frikshme që sa vinte e zgjerohej. Pa Arturin ndihej krejt e pambrojtur. Po të ishte me Arturin, edhe pse me pasaportë italiane, do të ndihej e sigurt, se Arturi do të dinte ta mbronte. Kurse këta tipa, që hiqeshin si parimorë dhe si miq të Arturit, nuk e bindnin fare se ia kishin pa hile dhe se do të ishin dashamirës. Kishte ardhur si kishte ardhur ajo në Angli, ishte punë e saj dhe e Arturit, atyre s'kishte ç'u duhej. Ajo po dyshonte përherë e më fort se ata po e kobitnin. Me siguri kishin kobitur edhe Arturin: kishin bërë sikur do ta merrnin në makinë, kurse në fakt, kur ai po bëhej gati të hipte, e kishin nisur makinën rrufeshëm dhe qenë zhdukur. Se nuk kishte arsye që Arturi të kishte dashur vetë të mos hipte. Si do ta linte Borën të nisej pa të, me disa të panjohur, pa i dhënë më parë asnjë shpjegim?!

Kur pa se puna u zgjat si tepër, Sefa e tërhoqi me forcë dhe me ndihmën e Ardit dhe të Korabit e mori osh derisa e futi në hyrjen e ndërtesës. Riçardi e pa këtë skenë, ndonëse mjegullshëm, për arsye të dritës së paktë përpara hyrjes, dhe nxitoi në atë drejtim. Kur hyri, dera e ashensorit u mbyll. Në tabelën e ndriçuar pa se ashensori u ndal në katin e tretë.

Grupi qëndroi përpara derës së një apartamenti, të cilën e hapi Ilira, shërbëtorja e Tinës, njërës prej prostitutave të bandës. U shfaq edhe Tina dhe të dyja e panë vajzën me kureshtje. Sefa futi në fillim Borën, pastaj hyri vetë e pas tij të tjerët.

Bora mbeti për një çast e hutuar, pastaj u kthye nga dera dhe bëri ta hapte. Dera ishte e kyçur dhe ajo ulëriti:

- Më lini të iki! Kush dreqin jeni? Ç'ju duhet juve se si kam ardhur unë në Angli? S'keni punë me mua!

Askush nuk foli. Ajo vazhdoi të ulërinte me një thirravajë të thekshme duke e goditur çmendurisht derën me grushte. Sefa i bëri shenjë Korabit, i cili i vuri dorën te goja për t'i mbytur britmat. Bora i dha Korabit një grusht në hundë dhe iu sul Sefës duke e goditur me grushte edhe atë e duke klithur si e marrë:

- Ku është Arturi?

- Të thamë që do të vijë. Rri urtë!

Bora e pa me urrejtje.

- Të rri urtë?! Unë isha me Arturin dhe nuk kam punë me ju, qofshi edhe miqtë e tij! Ku është Arturi?

Askush nuk foli. Bora ua dha sërish ulërimave me sa i hante gurmazi. Sefa e mbërtheu fort nga krahët dhe Korabi, të cilit i dukej një vijëz gjaku në buzë, i vuri në hundë një garzë që e kishte përgatitur Tina. Bora u hakat t'i shmangej duke u kukëzuar, por nuk mundi; koka iu var, trupi iu zgajt dhe Sefa arriti ta mbante përpara se të shakullisej në dysHEME.

- Çojeni në dhomë.

Korabi dhe Ardi u vunë në lëvizje, e cangëluan Borën si shqerrë dhe të udhëhequr nga Ilira e çuan në një dhomë tjetër.

Arturi dhe Serxhi rrinin në një bar me nga një gotë uiski përpara. Arturi dukej i përhumbur, krejt ndryshe nga në Milano, kur shfrynte si kalë i tërhuzur. Tani që bindur përfundimisht se nuk do ta shihte më kurrë me sy atë vajzë dhe ndihej në pragun e vetëvrasjes. Sot e dy muaj, kur kishte nisur atë lojë jetëvdekjeje me të, nuk pati pandehur kurrë se do të vinte një ditë që të ndihej i tillë. Mallkonte ditën e njohjes me të, por mallkonte më shumë këtë të ashtuquajtur mik që kishte përballë, puthadorë i bosit të vet, që nuk kishte treguar kurrfarë gatishmërie që ta prishte ujdinë pa gjobë. Dhe njiheshin prej vitesh.

Serxhi mori një çantë lëkure nga karrigia, e vuri mbi tryezë dhe nxori prej saj një qese plastike të fryrë.

- Urdhëro, pesëdhjetë *madhoshe*.

Arturi i numëroi duke u përpjekur të mos binte në sy të klientëve. Ishin pesë pliko, secila me 10 mijë sterlina. U përpoq ta fuste qesen në xhepin e brendshëm të xhaketës, por nuk ia nxinte. Serxhi hoqi dy pliko nga çanta e vet, i rراسi në xhepa dhe ia dha çantën Arturit, i cili e mori me inat dhe futi qesen në të. Serxhi e pa me një shprehje të rreptë, mori gotën dhe e ngriti.

- Dhe nesër që në mëngjes të zhdukesh.

- E di edhe pa ma thënë ti.

- Nëse për ndonjë mut debolese a fantazie vazhdon të vërdallisesh këtej, je i vdekur.

- E di.

- Bukur. - Serxhi surbi një gllënjë e vazhdoi: - Gjithsesi nuk mund të rri dot pa të të përgëzuar. Dikur unë kam provuar metodën e

gjuetisë nëpër gjimnaze, po s'ishte gjë, vajzat e bukura nuk afroheshin. Në kishë është ndryshe - të gjithë të presin me mirësjellje dhe mund të ulesh pranë çdo vajze. U buzëqesh, i ndihmon të hapin Biblën në faqen e duhur, u bën foto me dixhital dhe i çon me JPEG nga çdo Internet-Kafe deri në fund të botës. Me një fjalë, gjeniale. Si dreqin të shkoi në mendje?!

Riçardi rrinte në fund të korridorit duke tymosur një puro, në pritje që të pikaste se në cilën derë qe futur grupi me vajzën.

Dera e ashensorit u hap dhe prej saj doli Serxhi, me xhepat e xhaketës të fryra. Ai u drejtua për tek apartamenti i Tinës pa vënë re se ndodhej nën përgjimin e dikujt. Riçardi e njihte atë pjesëtar të bandës dhe fiksoi derën me sy.

Të gjithë rrinin në kolltukë me nga një gotë pije në dorë. Ilira u kthye nga dhoma në sallon.

- Si duket? - e pyeti Serxhi.

- Top në gjumë.

- Ia paskeni dhënë dozën për operacion kështu?

U dëgjua zilja e derës që shungulloi për tmerr. Ishte kaq kobsjellëse, sa të gjithë u hodhën përpjetë zemërngjirë dhe për sekonda të tëra vetëm shihnin shoqi-shoqin në sy. Zilja u dëgjua sërish, këtë herë më këmbëngulëse. Sefa iu drejtua Serxhit:

- Mos të ka ndjekur ai mut sekseri për të të thënë ndonjë gjë që ka harruar?

Serxhi nuk pati kohë t'i përgjigjej, se zilja u dëgjua sërish, e egër dhe nervoze. U dëgjua edhe një zë jo i panjohur për ta.

- Jam detektivi Uilkins. Hapeni derën.

Të gjithë i mbuloi hija e vdekjes, sidomos Ardin dhe Tinën.

- Nga dreqin mbiu?! - tha Serxhi me urrejtje. - Shko hapja, mutit.

Tina hapi derën dhe hyri Riçardi. Ai tregoi stemën dhe i pa të pranishmit me qesti dhe me një vështrim që sikur i përshkoi të gjithë tepërtej.

- Ku e keni kapon?

- Në shtëpinë e vet.

Riçardi i hodhi një sy sallonit.

- Po zoçkën?

Askush nuk bëzajti. Ishte një situatë e mbushur me një heshtje kërcënuese, të egër dhe shpërthyesë, me fytyra të murrëtyera, dhe

sikur vizitori të mos kishte qenë Riçardi, një ujk plak i regjur me jetën e botës së krimit, mjeshtër i basifondëve, por një aguridh pa përvojë, do të qe trembur për vdekje.

- Mos më vononi. - Zëri i dedektivit qe i ashpër. - Shpejt, se dua t'i hedh një sy.

Serxhi i bëri shenjë Tinës që ta çonte atë *fuks* të mallkuar në dhomën ku ishte Bora.

- Ejani, z. detektiv, - iu drejtua Tina me një zë të sheqerosur.

Riçardi hyri në dhomën e llirës dhe qëndroi pranë shtratit ku flinte vajza. Ia nguli sytë dhe duke e kundruar për sekonda të tëra i mrrulur, seç mërmëriste me vete. Tina më pas betohej se e kishte dëgjuar të nënëriste, por a lutje, a mallkim, a mahnitje, nuk e kishte kapur dot. Kurse fjalët, Dreçin, s'më kanë zënë sytë krijesë më të bukur, ai i kishte shqiptuar zëplotë dhe ajo i kishte dëgjuar qartë.

Riçardi u kthye në sallon me një shprehje të habitshme në fytyrë, të nemitur dhe të eshkët, si të mbartte një kumt gjëmëtar, a ndoshta pa kurrfarë kumti, por thjesht me mbresën e trallisjes që kishte pësuar teksa kishte parë vajzën.

- I thoni kapos se nesër paradite, në orën 10, e pres në *Melt*.

Ngriti paksa kapelen në shenjë përshëndetjeje dhe doli. Për disa çaste sundoi heshtja. Serxhi nxori celularin, por ngaqë i dridheshin duart, i ra përtokë. Ardiani e mori e ia dha, por ai s'punonte.

- Shkërdhatë! - e shau Serxhi dhe e hodhi celularin në divan.

Korabi u tregua i shkathët dhe i zgjati të vetin.

- Ç'mutin ma jep? - ia plasi Serxhi. - Bjeri Kapos e ma jep.

Kryebanditi, i njohur me nofkën Tigri, por me emrin e vërtetë Mentor Bardhi, kishte mbaruar gjimanzin me *medalje të artë*, qe diplomuar *cum laude*<sup>1</sup> për kimi industriale dhe kishte filluar punën në një fabrikë çimentoje. Rroga ishte e ulët, se prodhimi konkurrohej nga importi, ndaj kishte shkuar në Athinë për të gjetur një punë më të paguar. Atje qe njohur me ca djem që punonin si tutorë prostitutash. Nga natyra ishte sa tip i shkathët e i guximshëm, aq edhe diplomat e i matur. Me marifet kishte zhdukur nga skena tre nga rivalët më të fuqishëm, dy duke i vrarë me dorën e tij, të tretin duke e kërcënuar, dhe kishte shtënë në dorë 9 nga prostitutat e tyre, të cilat i trajtonte mirë dhe u linte goxha përqindje, ndryshe nga tutorët e tjerë, që i

<sup>1</sup> Shkëlqyeshëm



ripinin. Madje disa prostituta kishin braktisur tutorët e tyre dhe kishin kërkuar mbrojtjen e tij. Ngaqë i doli nami si njeri që *të zhdukte*, ia kishin frikën, por i kishin bërë edhe dy atentate, nga të cilat kishte shpëtuar për mrekulli. Njërin atentator e kishte zbuluar dhe i kishte prerë fytin, kurse tjetrin nuk kishte arritur ta zbulonte. Gjithsesi, duke u ndier i rrezikuar, doradorës i kishte kaluar prostitutat në Londër. Pak përpara se të nisej vetë qe njohur me një prostitutë shumë të bukur me emrin Veronika Stefani, e cila ishte rishtare në *zanat*. Ajo kishte dëgjuar për bëmat e tij, kishte rënë marrëzisht në dashuri me të dhe kishte braktisur tutorin e vet. Në Londër kryebanditi e mbajti si të dashur dhe e bëri menaxhere të prostitutave.

Banonte në vilën *Springtime* në *Grove Road*, në fund të *Mile End Road*. Ishte një ndërtesë e bukur dykatëshe, e rrethuar me kangjella, me një oborr të gjerë të shtruar me beton, me një kopsht plot pemë e lule dhe me një hijesore verore. E kishte marrë me qira prej dy vjetësh për tangarllëk, se në gjithë atë shtëpi banonte vetëm ai me Veronikën, shpesh edhe vetëm.

Kishte kaluar mesnata. Salloni i gjerë dhe luksoz në katin e parë ndriçohej ëmbël duke krijuar një atmosferë romantike. Tigri dhe Veronika kërcenin me faqet puqur nën tingujt e një muzike të prajshme që përhapej nga një boks stereo. Ishte rreth të tridhjetave, i pashëm, me flokë të zinj, të gjatë, të lidhur tufë prapa kokës, me mustaqe e mjekër të shkurtër. Veronika ishte një bjonde shumë e bukur rreth të njëzet e pesave. Në tryezën që rrezëllinte nga pjatat, shishet e gotat vezullonin dy qirinj të ndezur.

U dëgjua zilja e telefonit. Tigri ngriti dorezën dhe njohu zërin e Serxhit.

- Malli mbërriti, shef, por na ndodhi një punë muti.

- Çfarë?

- Sapo na bëri një vizitë kaleci.

- Kaleci?! - Tigri gapërroi sytë nga habia. - Çne kaleci? Dhe aq më tepër çne tani, kaq vonë?

- Duket i kishte parë këta trapat kur e çuan vajzën te Tina.

- Kur e çuan?

- Afër mesnate, me të mbërritur në Soho. Unë ndenja me sekserin, këta zbatuan planin sipas porosisë tënde.

- Dhe i pa kaleci? Si dreqin?... Po ata nuk i hapën sytë? Më jep Sefën.

U bë një pauzë e vogël dhe Tigri dëgjoji zërin e Sefës.

- Urdhëro, shef.

- Si dreqin ju pa kaleci në mes të natës?

- Ku ka natë në Soho, shef. Ne e ndaluam makinën në vendin më të errët të mundshëm, por... fuksi me sa duket i ka sytë si të bufit, sheh dhe natën.

- Buf je ti, shkërdhatë mutil! Se ty të ngarkova ta çoje vajzën te Tina pa rënë në sy. Pse s'thua që e paske nxjerrë në paradë në mes të Sohos?!

- Unë të thashë ta çonim nga aeroporti drejt e në *Nirvana*, shef, po s'më dëgjoje. Andej s'do të binim kurrë në sy.

Tigrit i hipën kacabunjtë dhe u bë si i ndërkrayer.

- Dëgjo ti, burgaxhi, rritu edhe pak, pastaj më jep mësimë! Nuk e çova në *Nirvana* për arsye psikologjike, po ku ke haber ti nga psikologjia! Po ta çoja drejt në *Nirvana*, në atë mjedis kurvash, ajo rrezik të ikte nga mendja! M'u duk më e udhës ta çoja në një mjedis familjar dhe këtë punë ta besova ty, por ti e dhjeve...

- Ke të drejtë, shef, por ja që ndodhi.

- Ndodhi, ndodhi, po e di sa më ka kushtuar ajo? Paratë ia dha Serxhi sekserit?

- Po. U mor malli, u dhanë paratë.

Tigri grafulloi dhe kërcëlliti dhëmbët.

- Po mirë o trap, nuk e di ti që në mesnatë kaleci sillet vërdallë nëpër Soho? Pse s'e çuat më vonë?

- Po ku ta mbanim? Ne zbatuam skemën tënde, lamë sekserin drangull në aeroport dhe ia mbathëm me vajzën, por në makinë ajo u bë si e çmendur. Nuk e ke idenë si u bë! Këlthiste në kupë të qiellit dhe përpëlitej, aq sa ishte rrezik të binim në sytë e policisë dhe të na arrestonin.

- Po në sytë e policisë ratë, o hajvan! Fuksi nuk është i policisë?

- Në fakt, deri te shtëpia e Tinës, nuk na ndali kush. Atje, për dreq, qëlloi fuksi.

- Pse nuk ia vutë narkozën që në makinë?

- Prapë do të binim në sy, se hallku do thoshin ç'janë këta që nxjerrin nga makina një të vdekur a të droguar...

- Nuk bindem fare, Sefë, dhe ja ku po të them që e ke dhjerë punën! Bëra gjithë ato shpenzime për të... Dërgova dhe Serxhin në Itali... Tani ka rrezik t'i laj duart prej saj! - Tigri dukej sikur nuk mbushej dot me

frymë nga nervozizmi, turfullonte dhe lëvrinte sa nga një cep në cepin tjetër të tryezës.

- Ne e bëmë tonën, po s'na eci. Ç'të them tjetër?

- Mirë, Sefë, mirë. Nuk mbyllet me kaq kjo melese, - i dha fund bisedës Tigri dhe përplasi telefonin.

Muzika vazhdonte, por Tigri u lëshua në kolltuk duke shfryrë. Veronika kishte kuptuar gjithçka dhe nuk i bëri asnjë pyetje, megjithëse kishte pushtet mbi të dhe mund t'i bënte çfarëdo pyetjeje në çfarëdo rrethane. Ajo vetëm e vështroi në sy dhe foli në mënyrë sentenciale:

- Ke shumë të drejtë të nevrkosesh, Mentor. Por po qe shkruar të shkojë ters një gjë, ruhu sa të duash, ashtu do të shkojë se s'bën.

Ajo i mbushi një gotë shampanjë, mbushi dhe të vetën dhe e nixti të pinte që ta kalonte sadopak turbullimin.

Gjergji mori një videokasetë dhe tri fotografi të Borës dhe i mbështolli mirë me një qese plastike, të cilën e futi në një qese tjetër dhe këtë të fundit në një xhep të brezit. Në një xhep tjetër futi qesen me euro që i kishte këmbyer me paratë e shtëpisë.

Eci drejt portës, u mbush me frymë dhe përqafoi t'ëmën. Ajo e ligjoi në flokë me ujë të bekuar, që e kishte marrë në Shën Andou, u ngashërye, e puthi dhe ia lagu fytyrën me lot. Edhe ai e puthi, bëri kryq, hodhi në krah çantën e vogël dhe doli në rrugë. E ëma nuk ia ndante sytë. Ai ktheu kokën, e përshëndeti me dorë dhe u zhduk prapa kthesës. Por ninëza e saj nuk iu nda. Sidomos dhimbja në sytë e saj dhe dridhja e buzëve të saj. Ajo qe lutur për të dhe i kishte dhënë bekimin. Në kishë kishte dëgjuar se bekimi është një aurë e mistershme që ndikon mbi fatin, një lloj timoni që e drejton. Ai nuk besonte në këto gjëra, madje edhe kryq nuk kishte bërë që në fëmijëri, por uronte që këto gjëra ezoterike, të tejnatyrshme, të pakapshme për mendjen e tij, të ishin ndikimsjellëse.

Në det të hapur shkiste një skaf i mbushur me emigrantë ilegalë - të rinj, burra, gra e fëmijë - në mes të të cilëve ndodhej Gjergji. Ai vështronte ujanën e errët të paskajshme i zhytur në mendime. Në largësi u dukën disa drita vizëlluese dhe ai fërgëllloi nga emocioni. Ndihej i trullësuar nga shpejtësia dhe nga njëtrajtshmëria vrastare e syprinës së detit. O Zot, tha me vete kur pa dritat. Ndoshta janë të

bregut. Papritur u dëgjua një si zukamë grerëze që herë zhangëllinte e herë fashitej derisa u kthye në një rrapëllimë të ngjashme me atë të helikopterit. Drejtuesi i skafit nxori një pistoletë dhe duke britur me zë të egër, të pabesueshëm për një djalosh të ri si ai, ua drejtoi klandestinëve.

- Hidhuni në det! Të gjithë në det!

Pasagjerët e panë të shastisur dhe shpërthyen në ulërima, protesta e sharje. I ndihmuar nga një mjekrosh me trup xhuxhi drejtuesi i gomones iu sul udhëtarëve për t'i flakur vetë në det. Të rritur e fëmijë u mbërthyen nga paniku, por të detyruar nga tyta e revolverit filluan të hidheshin në ujë me britma tmerri. Gjergji e mblodhi mendjen top në kohë. Hoqi me të shpejtë këpucët, këmishën dhe pantallonat, u hodh në ujë, u zhyt, doli në sipërfaqe dhe nisi të notonte ritmikisht. Rreth tij pak njerëz notonin. Ata që nuk mundeshin filluan të zhyteshin. Ai pa dy trupa fëmijësh që uleshin e ngriheshin sipas valëzimit të dallgëve.

Në të aguar mbërriti në breg dhe u plandos buzë ujit i kalltisur për vdekje. Mbështeti kokën në rërë i përgjumur nga lodhja dhe shurukama e valëzave. Qëndroi i palëvizur për minuta të tëra, derisa i erdhi fryma, pastaj pa rrotull se mos e kishte pikasur ndonjë rojë bregdetare. Vendi ishte i shkretë, nuk dukej xhanxhin.

Nxori nga brezi videokasetën dhe i hodhi një sy. Nuk ishte i sigurt nëse i kishte hyrë uji. Nxori kartëmonedhat, që qenë lagështitur, por jo dëmtuar. Shyqyr, tha me vete dhe u mbush me frymë. Shyqyr. Duke mposhtur një ndjenjë kapitjeje, sidomos shukatjen e gjumit, nisi të ecte zvarrë. Uronte me shpirt të mos binte në duar të karabinierëve.

Ecte e ndalonte, më shumë i fshehur gëmushave të bregut, herë-herë prapa ndonjë depoje. Diku pa një rojë, që edhe ai e pa dhe nuk u habit. Me siguri nuk ishte e para herë që shihte një njeri vetëm në mbathje e kanotjere. Gjergji iu afrua rojës, e përshëndeti dhe iu lut t'i gjente një palë këpucë, pantallona e këmishë. *Vi paghero*, i tha. *C'e lo dei soldi*. Roja e futi në kabinë dhe nisi një djalë të vogël për diku. Pas nja dy orësh djali solli katër palë këpucë, dy këmisha e dy palë pantallona. Gjergji zgjodhi ç'i rrinte më mirë dhe roja i mori 10 euro.

Gjergji i tha se donte të shkonte në Milano dhe roja e orientoi si të shkonte në stacion. E bëri rrugën më këmbë nga frika se mos ngatërrohej në linjat urbane. Ishte bërë darkë kur mbërriti në stacion. Deri në Milano udhëtoi gjithë natën dhe një pjesë të ditës tjetër.

Ai qytet i madh e i panjohur e rraskapiti derisa mbërriti në apartamentin për ku qe nisur, po ky mundim s'qe asgjë karshi llahtarisë që kishte përjetuar kur qe hedhur nga skafi në det. Kishte dy shokë gjimnazi në Milano, kishte dhe adresën e tyre, por ata kishin ndërruar shtëpi dhe hoqi shumë derisa mbërriti në banesën e re. Po të kishte qenë me paraqitje të rregullt ndoshta s'do të qe munduar aq, se që në fjalët e para i ngjalli dyshime zonzës së shtëpisë në të cilën kishin banuar shokët e tij. Edhe italishten nuk e fliste mirë dhe i erdhi keq që nuk i kishte kushtuar rëndësi sa anglishtes. Për anglishten e kishte ndihmuar edhe hapja e asaj kishës baptiste ku shkonte në çdo shërbesë dhe fliste anglisht me dy pastorët, me gratë dhe fëmijët e tyre. Në kishë vinin edhe grupe fermerësh që ai i shoqëronte në turnetë që bënin në Shqipëri dhe e kishte thyer gjuhën goxha.

Gjithë të dhënat që kishte mundur të mblidhte për tipin që i kishte rrëmbyer të motrën (çka nuk e vinte në dyshim) përmbledheshin në hiçgjë: se quhej Artur Golemi dhe se kishte qenë me punë në Milano. Se ç'punë kishte bërë apo bënte, ku banonte, me ç'njerëz kishte lidhje, nuk kishte mundur t'i mësonte.

Dy shokët, Altin Prifti dhe Elton Kozara e pritën me gëzim, i dhanë për të ngrënë dhe e pyetën pse kishte ardhur ashtu papritur pa u bërë një telefon më parë. Kur Gjergji ua tregoi arsyen, ata u tronditën. Sidomos Altini, një djalë syshkruar e flokëçelë, e ndjeu thellë atë bolbë, se i kujtohej mirë Bora e vogël, që jo më shumë se para pesë-gjashtë vjetësh e hidhte hopa në ajër kur shkonte te shtëpia e Gjergjit. Toni, një djalë zeshkan, rrondokop e fytyrëbuçko, nuk kishte rastisur ta shihte Borën, por lajmi gjithashtu e ngiethëroi.

Dhoma ishte gjysmë e ndriçuar dhe binte në sy mungesa e rregullit. Që në shikimin e parë dukej se banorët e saj merreshin me drogë. Në tryezë ishin dy tasa, njëri me pluhur të bardhë, tjetri me bojëkaf, një peshore farmacie, një tabaka e allasojshme, gjithë pipeta të vogla të ngallmuara nën të, të cilat mbusheshin me pluhurin që përhapej me një copë kartoni mbi gojëzat e tyre, shiringa, fletë të holla, kupëza metalike e mjete të tjera.

Gjergji u tregoi tri fotografi të Borës dhe Altini u habit me ndryshimin e saj: nga një çupëlinë me bishtaleca, ajo qe bërë goxha vajzë.

- Shkuat në polici?

- Po. Por donin prova që është rrëmbim personi, se vajza mund të

kishte ikur me dëshirën e saj. Gjë që ashtu është. Sa për atë që është minorene nuk e rruajtën fare. - Gjergji heshti pak e vazhdoi: - Mezi mora një të dhënë për atë masakara: se rri në Milano. Emrin e ka Artur Golemi. E keni dëgjuar?

Altini dhe Eltoni mblodhën supet.

- Të paktën mora vesh qytetin, se ku ta kërkoja në gjithë Italinë. Ju keni hallet tuaja, por mbase më ndihmoni t'i bie në gjurmë. Kam sjellë një kasetë. Poqese nuk është dëmtuar në det, do ta shihni për fytyrë.

Gjergji nxori videokasetën dhe ia dha Altinit, i cili e kontrolloi me sy, e futi në aparat dhe në ekran doli figura. Gjergji mori frymë i lehtësuar. Doli kori, ku ishte edhe Bora. Një ceremoni pagëzimi në një lumë të vogël jashtë qytetit. Gjergji kishte panoramuar edhe peizazhin - fusha të mbjella, pemë e aty-këtu, vila të reja e të bukura; në largësi shquheshin disa kodra dhe përtej tyre Dajti. Lumi ku janë futur Bora në këmishë, Arturi i zhveshur nga mesi e lart dhe pastori me bluzë, të tre përgjysmë në ujë. Pastori i zë hundën Borës, e zhyt mbrapsht dhe e nxjerr. Të njëjtën gjë bën edhe me Arturin. Arturi dhe Bora duke dalë nga lumi të dy të qeshur. Figurat e tyre vijnë duke u afruar sa zënë gjithë ekranin.

Pikërisht këtu, ku figura e Arturit duket qartë, Altini dhe Toni folën gati me një gojë:

- Oul! Po ky është Genci. Genc Dalipi nga Fieri. Një gangster i ndyrë!

Gjergji i pa me habi dhe një shpresë e mekur, si një rreze e zbehtë, ia përshkoi zemrën.

- E njihni?

Altini e riktheu shiritin dhe figurat e Borës dhe të Arturit ngrinë në pozicionin në breg të lumit.

- Që ç'ke me të. Gangoja i burgut, dora vetë.

- Ka qenë në burg?

- Të shohim të gjithë kasetën dhe të tregojmë ne.

Altini shtypi butonin e pultit dhe pamjet ndërroheshin. Bora në kishë e ulur pranë Arturit. Bora duke u shkrirë gazit me të në Grupin e të Rinjve. Bora duke lagur Arturin me zorrën e ujit në oborrin përpara kishës. Arturi duke fotografuar Borën me një aparat dixhital.

Altini e ndali aparatin në çastin kur Arturi është duke fotografuar Borën, e cila duket e lumtur.

- S'e luan topi, - tha ai. - Kemi qenë në të njëjtën kohë me të në burg në Zvicër. I hëngrëm tre muaj, po nejse. Atëherë edhe ai merrej me drogë. Tip sherrxhi, pordhac e mujshar. Me kë nuk është rrahur. Ne i hapnim udhë dhe zumë njëfarë shoqërie. Tani ka një grup prostitutash.

Gjergji e pa në sy i bërë dyllë.

- Jo more.

- Po, Gjergji. po.

- Hej Zot! - Gjergji tregoi figurën e ngrirë në ekran në stopkamera.

- Dhe hiqej si shenjtor. Thoni se e ka mashtruar Borën për ta bërë prostitutë?

Altini dhe Toni nuk folën, por ai e kuptoi se heshtja e tyre ishte një heshtje që fliste. Gjergji zuri fytyrën me duar dhe nuk dinte ç'të thoshte.

- Me sa dimë ne, në Milano i ka nja pesë a gjashtë.

Gjergji e bridhte shikimin sa te njëri te tjetri. E mori Borën për ta bërë prostitutë?!, foli më shumë me vete. Brofi nga kolltuku dhe zuri të shalakatej nëpër dhomë si i ndërkrayer. Atë vajzë të mitur?! U lëshua sërish në kolltuk dhe zuri kokën me duar. Do ta vras, për nder. Do ta zhduk.

Altini dhe Toni e shikonin me shqetësim dhe këmbenin vështrime.

- Mos e merr me rrëmbim, Gjergji - foli Altini me ton të butë. - Duhet zhbiruar puna. Asaj mund t'i ketë rënë në kokë për të dhe... çfarë nuk ndodh. Ti e vret atë horr, por ajo hidhet në rrotat e makinës.

Gjergji piu një gotë ujë dhe u mbush me frymë.

- Ta zëmë se e do vërtet, po si mund ta lë në duart e një njeriu të tillë? Leqë nuk është në moshë, por edhe sikur të jetë, a mund ta lë të ketë për burrë një kodosh femrash?

-Ç'burrë, o Gjergji! Se mos e ka marrë për grua ai! - foli Toni, që deri atëherë kishte heshtur. - Kjo do të ishte gjysma e të keqes. Që të flasim hapur, unë them se e ka marrë për prostitutë. Se me atë punë merret.

- Me siguri, - pohoi Altini. - Ajo mund ta dojë, por ai për atë punë e ka marrë. Tmerr.

Gjergjit iu mbushën sytë me lot dhe zuri sërish kokën me duar.

- Më kujtohet si më hidhej në qafë kur vija te shtëpia jote, - tha Altini dhe fshiu sytë. - Ishte tetë a nëntë vjeçe...

Gjergji nuk u mbajt më, i buisën lotët dhe foli duke iu dridhur zëri:

- E priste një e ardhme tjetër... Ka qenë aq e zgjuar... Me të gjitha notat dhjeta që nga klasa e parë... nxënësja më e mirë e klasës çdo vit...

- Ai duhet gjetur sa më parë, - tha Toni. - Sa ende nuk e ka nxjerrë në rrugë.

- Po ku e njoh unë Milanon? Të dal e të pyes prostitutat shqiptare? Unë nuk e di as ku rrinë. Pastaj, hëpërhë ai mund ta mbajë të mbyllur. - Ai ia hidhte shikimin herë njërit e herë tjetrit. - Njihni ndonjë nga prostitutat e tij?

- Jo, - tha Altini dhe buzëqeshi si me turp. - Nuk shkojmë me to, Gjergji. Po do të përpiqemi t'i biem në gjurmë.

Gjergji e ndjeu veten në siklet.

- S'ju takon juve, por nuk di nga t'ia mbaj...

- Bora është edhe motra jonë dhe ne do të bëjmë çmos t'i biem në gjurmë atij horri, - tha Toni. - Ai ka prostituta edhe në Torino, po më shumë rri në Milano.

Pasai një heshtje e gjatë.

- Kam hall edhe për një vend për të fjetur. Në hotel nuk më qasin, s'kam dokumente. Mund të më mbani për pak kohë? Më pas mund të rregullohem gjetkë, po mbase kjo punë nuk zgjat.

- Mund të flesh në divan? - e pyeti Altini

- Oul! Feja vetë. - Ai heshti një grimë e shtoi: - Do të kërkoj dhe ndonjë punë. Kam ca para, po dua t'i ruaj, se s'i dihet si rrjedhin gjërat. Me italishten nuk jam mirë, por merrem vesh.

- Mos kërko punë, - i tha Toni. - Po të kapi policia, të kthen. Mund të punosh te ne? Të ndash drogën në racione.

Gjergji tundi kokën.

- Ju falënderoj shumë, bile. Kam bërë ca shkrime për drogën, për kontrabandën... Mos ma merrni për keq, nuk e kam pasur me ju.

- Të tre kemi qenë nxënës të mirë, - tha Toni. - Të tre kishim ëndrra që nuk i realizuam dot.

- Për Gjergjin s'mund ta thuash, - ndërhyri Altini. -. U diplomua në letërsi dhe ka punuar gazetar. Por e le për shkak të rrogës, apo jo, Gjergji?

- Po. Me kamerën nxjerr më tepër, të paktën 500 euro në muaj. Megjithatë, kur të gjej Borën, mund të rri këtej. Me të parë, me të bërë. Nejse. Ju falënderoj shumë, çuna!



Ishte një mbrëmje e butë fundqershori si e endur me rreze drite të shumëngjyrshme. Altini dhe Toni ecnin trotuarit duke parë përçark me vëmendje. Pranë semaforit, në kryqëzimin e larë nga dritat laracane, panë disa prostituta. Kur doli shenja e kuqe dhe makinat ndaluan, ato u sulën te drejtuesit. Disa u tregonin gjoksin, disa mbaheshin serioze, disa bisedonin për çmimet. Vetëm njëra hipi në makinë. Kur u shfaq drita jeshile dhe makinat u larguan, prostitutat u tërhoqën të mërzitura. Me të parë djemtë, një brune dhe një bionde u dolën përpara.

- Hë, kinga? Doni ca shkundje?

- Çmimin e kemi me orë, jo me ejakulacione, - tha bjondja. - Brenda orës mund ta bëni sa herë të doni.

- E kemi dhe me tërë natën, po është më shtrenjtë, - tha brunia.

- Njihni ndonjë vajzë shqiptare? - e pyeti Altini.

- Paskeni dalë për duçka shqiptare? Provoni tonat dhe do të mbeteni të kënaqur.

- Nga ju kemi?

- Nga Rumania.

Altini u dha nga 10 euro secilës.

- S'kemi dalë për duçka, po për punë tjetër. E dini ku rrinë shqiptaret?

Prostitutat i morën paratë, i futën në çanta dhe u bënë të përzemërta.

- Andej, - tha bjondja. - Po s'u morët vesh me to, ejani te ne.

- Patjetër, - ia ktheu Altini.

Ata vazhduan trotuarit duke vëzhguar prostitutat. Disa rrinin grupe qoshja e një rruge tjetër.

- Punë muti! - tha Altini. - Nga mund t'i dallojmë? Se mos e kanë të shkruar në ballë.

- Ka ndonjë shqiptare këtu? - pyeti Toni.

Prostitutat që rrinin grup kthyen kokat. Njëra foli në shqip:

- Ka. Ejani, bukurosha. Keni duçka shqiptare sa të doni!

Ata u drejtuan për tek ato dhe piketuan dy. Njëra ishte një qukse trupvogël, por e hijshme, që qeshte papushim. Tjetra ishte një fytyrëmushkë, me flokët cirka-cirka. Nisën të bisedonin për çmimin e më në fund ranë dakord.

- Së pari hamë diçka, - tha Toni. - Meqë e keni me orë, do t'ju paguajmë edhe për kohën e ngrënies. Ç'thoni?

- Ku ka më mirë! - tha quksja. - Rrallë na ndodh kështu. Shkuan në një bar, porositen dhe Altini u hodh drejt e në temë.

- Dëgjoni, vajza: e njihni një tip me emrin Artur Golemi?

Prostitutat u panë sy më sy dhe morën një pamje serioze, madje të trembur.

- Jo, - tha quksja.

Altini nxori disa kartëmonedha dhe i vuri mbi tryezë.

- Nëse nuk e njihni, mbase mund të na jepni emrin e ndonjëres që e njih. Shpërblimi është 100 euro secila. Për të na dhënë një emër do të fitoni sa për një orë pallim dhe pa mundim fare.

Prostitutat shkëmbyen vështrime me shoqa-shoqen dhe duket se u morën vesh.

- Njohim njërën, - tha fytyrëmushka. - Është në grupin e tij. Po nuk do ta bëni për fjalë me njeri, se ai është kafshë dhe shyqyr që nuk kemi të bëjmë me të.

- Mos kini merak, - tha Altini. - Si e quajnë?

- Besa Bregu. Do t'ju tregojmë vendin ku rri zakonisht dhe si vishet. Mund ta takoni që sonte.

- Sonte ndoshta jo. Sa për siguri, mund të na jepni një numër celulari?

Prostituta fytyrëmushkë nxori celularin dhe shënoi numrin e vet në celularin e Altinit. Altini i ra celularit dhe u bind se numri që i saktë. U dha kartmonedhat dhe surbi një gllënjë pije.

- Po për të palluar ku do të na çoni?

- Nuk do t'ju çojmë asgjekundi. Por do t'ju paguajmë. Juve s'ju prish punë, apo jo?

Ai nxori edhe dy kartëmodha 50-euroshe dhe ua dha. Ato mbetën të kënaqura.

Gjergji peshonte pluhur, e hidhte në tabaka, e shpërndante me kujdes dhe ai binte në pipeta. Kur mbusheshin të gjitha, secilën e zbrazte në një qeskë të vogël plastike mbi të cilën që stampuar emri i drogës. Hyri Altini me vrap.

- Kemi lajme, Gjergji!

Gjergji e pa me interes. Dukej i lodhur dhe fërkoj sytë.

- Gjetëm fillin që mund të na çojë te gijpëra. - Ai hapi frigoriferin, mori dy kanaçe birrë, i hodhi një Gjergjit dhe piu një gllënjë nga e veta. Pastaj iu ul pranë. - Dozoti është në Milano. Po s'qe, do të shkojmë

me Tonin në Torino dhe do ta gjejmë. Ti s'do të luash prej këtu.

Gjergji e pa me mirënjohje. Nuk kishte menduar kurrë se dy shokët e klasës, që nuk i kishte patur shokë të ngushtë, do t'i gjendeshin kaq shumë. Ai kishte ushqyer bindjen se sa më e ngushtë të ishte miqësia, aq më i madh ishte detyrimi i ndërsjelltë. Mirëpo, për t'u habitur, ishte ndodhur në një situatë kur një shok i ngushtë e kishte lënë të zhgënjyer. Çudia është se shokët e ngushtë kanë edhe potencialin për t'u bërë armiq, tha me vete gjithë pezëm. Kurse shokët e zakonshëm, edhe në shtë ndihmojnë, nuk të bëhen armiq.

## 3

Të nesërmen në mbrëmje një automobil ndaloi pranë prostitutës fytyrëmushkë dhe Besa Bregut, një vajzë e hijshme hundëçipe, me një fytyrë tejet feminare, por me një kozmetikë të llucëruar. Ato u gjallëruan kur panë makinën. Toni ishte në timon, Gjergji në ndenjësën e pasme. Prostituta fytyrëmushkë bëri sikur nuk e njihte Tonin.

- Hë, djema? Doni pak qejf?

Toni përkuli trupin që ta shihte më mirë. Prostituta fytyrëmushkë i bëri një shenjë të lehtë me sy.

- Pse jo, bukuroshe. Prandaj ndaluam.

- Ne jemi dy dhe ju dy, - vazhdoi fytyrëmushka.

- Jo, unë e kam zoçkën time, ma jep pa para. Shoku im nuk ka. - Ai u kthye nga Gjergji. - Zgjidhe.

Gjergji shikonte herë njëherë e herë tjetrën.

- Të mbetet qejfi po të zgjedh shoqen tënde?

Ajo u hoq si e fyer.

- S'të pëlqekam unë? Ik pirdhu!

Prostituta fytyrëmushkë u largua duke vazhduar të sharat. Besës iu bë qejfi, por rrinte palëvizur.

- Ç'rri si hu? - i tha Toni. - Do të vish apo të gjejmë një tjetër?

- Të bisedojmë për çmimin.

- S'prish punë çmimi, - i tha Gjergji. - Hip.

Ai hapi derën dhe ajo iu ul pranë. Gjergji i hodhi një shikim të shpejtë. Toni nisi makinën.

Vetura ecte me shpejtësi në radhën e gjatë të veturave. Toni e ktheu në një rrugë anësore, që ishte më e errët.

- Ku po më çoni?

- Në ndonjë motel, - i tha Gjergji. - Nuk të pëlqen?

- S'më prish punë, ku të doni. - Ajo e hetoi në fytyrë. - Ju sikur nuk